



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 317/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Elmi Reçicës kandidat për deputet nga koalicionit PDK-AAK-NISMA paraqitur kundër komisionerëve të QV 2512D/02D, për shkak të parregullsive në numërimin e votave, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare në seancën e panelit të mbajtur me 15.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa A.nr 317/2017 e datës 12.06.2017, e parashtruar nga Elmi Reçicës kandidat për deputet nga koalicionit PDK-AAK-NISMA

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 12.06.2014, nga Elmi Reçicës kandidat për deputet nga koalicionit PDK-AAK-NISMA në të cilën pretendohet se me datën 11.06.2017 në vendvotimin 2512D/02D gjatë numërimit të votave nga ana e komisionerëve në këtë vendvotim është bërë gabim teknik sepse votat e Elmi Reçicës me nr.17 të PDK-së gabimisht i janë vendosur një rend më poshtë tek kandidatja Valdete Bajrami. Parashtruesi i ankesës kërkon që të bëhet rinumërimi i votave në këtë vendvotim.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultati preliminar nuk është shpallur nga KQZ-ja dhe se mund të ndryshoj në çdo moment, po ashtu Qendra e Numërimit dhe Rezultateve QNR ende është në fazën e procedimit të materialeve zgjedhore nga Qendrat e Votimit. Andaj rezultati zgjedhor nuk ka marrë formën përfundimtare, në momentin e shpalljes së rezultateve përfundimtare të QNR-së palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të Nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “Ankesat të cilat janë të palejuar dhe të pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A nr. 317/2017 më datën 15.06.2017

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 317/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Elmi Reçicës kandidat për deputet nga koalicionit PDK-AAK-NISMA paraqitur kundër komisionerëve të QV 2512D/02D, për shkak të parregullsive në numërimin e votave, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare në seancën e panelit të mbajtur me 15.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa A.nr 317/2017 e datës 12.06.2017, e parashtruar nga Elmi Reçicës kandidat për deputet nga koalicionit PDK-AAK-NISMA

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 12.06.2014, nga Elmi Reçicës kandidat për deputet nga koalicionit PDK-AAK-NISMA në të cilën pretendohet se me datën 11.06.2017 në vendvotimin 2512D/02D gjatë numërimit të votave nga ana e komisionerëve në këtë vendvotim është bërë gabim teknik sepse votat e Elmi Reçicës me nr.17 të PDK-së gabimisht i janë vendosur një rend më poshtë tek kandidatja Valdete Bajrami. Parashtruesi i ankesës kërkon që të bëhet rinumërimi i votave në këtë vendvotim.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultati preliminar nuk është shpallur nga KQZ-ja dhe se mund të ndryshoj në çdo moment, po ashtu Qendra e Numërimit dhe Rezultateve QNR ende është në fazën e procedimit të materialeve zgjedhore nga Qendrat e Votimit. Andaj rezultati zgjedhor nuk ka marrë formën përfundimtare, në momentin e shpalljes së rezultateve përfundimtare të QNR-së palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e sipërshtënuara dhe në kuptim të Nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “Ankesat të cilat janë të palejuar dhe të pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A nr. 317/2017 më datën 15.06.2017

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.